

KOSOVARJA

**FILLORETA
BALAJ-ELEZI,**
kosovarja multimilionere
në Amerikë





FILLIMI I NJË KAPITULLI TË RI.



KOMPLEKSI
ELIZA PARK A

Suharekë

+383 44 106 777 www.cimaks.com

Ka histori suksesi që tingëllojnë si legjenda urbane dhe histori që ndërtohen ngadalë, me sakrifica reale, vendime të guximshme dhe disiplinë që nuk lë vend për justifikime. Rrugëtimi i Filloreta Balaj-Elezi i përket kësaj të dytës. Sot ajo është një nga gratë shqiptare më të suksesshme në fushën e pasurive të paluajtshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me mbi 110 milionë dollarë volum total shitjesh dhe një portofol prej 23 pronash në SHBA, Kosovë dhe Shqipëri. Por gjithçka ka nisur shumë larg luksit që e rrethon sot...

Filloreta Balaj-Elezi, kosovarja multimilionere në Amerikë



E lindur në Prishtinë, Filloreta u përball herët me pasigurinë që solli lufta në Kosovë.

Në vitin 1999 familja e saj u nis drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës si refugjate.

Ishte një fillim i vështirë, pa garanci dhe pa mbështetje financiare...

Në atë kohë nuk kishte as plane të mëdha, as lidhje biznesi, por vetëm një vendosmëri të brendshme për të mos mbetur peng i rrethanave. Ajo e përshkruan atë periudhë si momentin kur i premtoi vetes se do të arrinte sukses, jo vetëm për ambicie personale, por për familjen dhe për ta bërë krenar babanë e saj.

Figura e Ukë Balajt, babait të saj, ka qenë boshti emocional dhe moral i gjithë rrugëtimit.

Ai mishëronte disiplinën, forcën dhe krenarinë për punën e nder-shme.

Edhe pas ndarjes së tij nga jeta në vitin 2023, ndikimi i tij mbetet i pranishëm në çdo hap të saj.

Çdo arritje, çdo investim dhe çdo rekord i ri mbart edhe një dimension personal: dëshirën për ta nderuar emrin e tij.

NDËRTOI REPUTACION TË FORTË NË MIÇIGAN...

Në vitin 2006, pas martesës në Prishtinë, Filloreta dhe bashkëshorti i saj, Neziri, u kthyen në SHBA me vetëm 2.000 dollarë.

Nuk kishte plan rezervë. Kishte vetëm një etikë pune të palëkundur dhe bindja se suksesi ndërtohet me durim.

Ajo hyri në botën e shitjeve dhe shumë shpejt u dallua si shitësja numër një në "Art Van Furniture". Ishte një fazë formuese, ku mësoi jo vetëm si të shesë, por si të kuptojë psikologjinë e klientit dhe rëndësinë e besimit.

Lëvizja vendimtare erdhi në vitin 2020, kur vendosi të kalojë në sektorin e pasurive të paluajtshme. Në një kohë kur tregjet globale përjetonin pasiguri, ajo me shpejtësi ndërtoi një reputacion të fortë në Miçigan si "REALTOR® në eXp Realty".

Brenda pak vitesh ajo arriti mbi 110 milionë dollarë volum total shitjesh, realizoi 23 milionë dollarë

në një vit të vetëm dhe u rendit si agjentja individuale numër një në Miçigan, duke fituar edhe titullin prestigjioz "ICON Agent".

Në Miçigan prona që zotëron ajo sot ka vlerë 1.3 milion.

PRONA NË MIÇIGAN, SHËNGJIN, PRISHTINË

Paralelisht me suksesin në shitje, ajo ndërtoi edhe portofolin e saj të investimeve.

Sot familja zotëron 19 prona në Miçigan, tri në Shëngjin dhe një në Prishtinë, shumica e tyre të shlyera plotësisht.

Një nga investimet më domethënëse në Evropë për të mbetët ai në Shëngjin, ku në vitin 2022 investoi 158 mijë euro, kurse sot ajo pronë vlerësohet rreth 300 mijë euro.

Dhe, për të kjo nuk është vetëm një rritje e kapitalit, por një lidhje simbolike me rrënjët dhe me premtimin e hershëm për të mos harruar kurrë nga erdhi.

Prishtinën ajo e sheh si një treg me energji të jashtëzakonshme dhe potencial të madh zhvillimi. Planet e saj afatgjate janë të qarta: të vazhdojë zgjerimin e portofolit në SHBA dhe, në një moment kyç të jetës, kur të arrijë 50 prona private në Miçigan apo kur t'i mbushë 50 vjet, të rikthehet më fuqishëm për të investuar dhe kontribuar në vendlindje.

Për të suksesi merr kuptim të plotë vetëm kur ndahet me komunitetin dhe vendin nga ku nisi gjithçka. Filloreta tregon se sa ishte për pushim në Kosovë shiti dy prona nga ndërtuesi, ku bashkëpunon si agjente. Ajo është një agjente e shitjes internacionale, me fitime kapitale.

KARRIERA, FAMILJA DHE BAMIRËSIA – MBI TË GJITHA

Megjithatë, dimensionin profesional është vetëm një pjesë e portretit të saj.

E martuar prej dy dekadash dhe nënë e dy fëmijëve, Filloreta ka ndërtuar një model jete ku karriera dhe familja nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.

Ajo punon nga shtëpia dhe e konsideron kohën me fëmijët si luksin



më të madh që ia ka dhënë suksesi. Për të pavarësia financiare është formë fuqizimi, veçanërisht për gratë që kërkojnë stabilitet dhe kontroll mbi jetën e tyre. Besimi në Zot dhe dëshira për të ndihmuar të tjerët janë pjesë thelbësore e filozofisë së saj. Ajo shpesh thekson se lutet për të pasur mundësi të japë më shumë... Suksesi në këtë kuptim nuk është vetëm akumulim pasurie, por mundësi për të krijuar ndikim.

NDËRTOI IDENTITET PROFESIONAL NË NJË TREG SHUMË KONKURRUES

Historia e Filloreta Balaj-Elezi nuk është, thjesht, rrëfim i një ngjitjeje financiare. Është kronika e një gruaje që doli nga një realitet i vështirë, ndërtoi identitet profesional në një treg konkurrues si ai amerikan dhe mbeti e lidhur shumë me rrënjët, familjen dhe vlerat. Dhe, në një kohë kur suksesi shpesh paraqitet si spektakël, rrugëtimi i saj tregon se fuqia e vërtetë ndërtohet në heshtje, me vizion, disiplinë dhe një qëllim që shkon përtej vetes.

Nderim Neziri

Vitet e tmerrit...

9 masakrat e Kosovës që tronditën njerëzimin



Masakra e Reçakut

Krimi serb mbi popullatën shqiptare të Kosovës në vitet 1998-1999 nuk kishte të ndalur. Ata nuk kursyen asgjë që kishin dhe shihnin përreth. Masakruan fëmijë, gra shtatzëna, pleq, dogjën shtëpi...

9 masakrat që i prezantojmë në vijim janë më të trishtuarat.

Por, nuk janë vetëm këto 9, ka edhe të tjera...

MASAKRA E PREKAZIT

Është pikërisht ajo që bëri bujë në gjithë botën e qytetëruar, masakra që preku thellë në zemrën e secilit njeri.

Masakra e Jasharajve më 5, 6 dhe 7 mars 1998, ku forca paramilitare hyn në fshatin Prekaz dhe vranë e masakruan 56 anëtarë të Lagjes Jashari, në mesin e të cilëve vritet edhe komandanti legjendar Adem Jashari.

MASAKRA E REÇAKUT

Ajo që alarmoi botën dhe strukturat veriatlantike është masakra e Reçakut, fshat i komunës së Shtimes.

Më 15 janar 1999 forcat paramilitare hyn në këtë fshat dhe bëjnë kërdi duke vranë, prerë e masakruar rreth 50 fshatarë të këtij fshati.

I madhi ambasador amerikan, Viliam Voker, pasi vizitoi të masakruarit, tha se në këtë fshat ishte bërë krim ndaj njerëzimit. Deklarata e tij bëri jehonë të madhe dhe i hapi mundësinë NATO-s për intervenim ushtarak mbi Serbinë, e që intervenimi zgjati 78 ditë, deri në çlirimin e Kosovës.

MASAKRA E IZBICËS

Më 28 mars 1999 forca të armatosura hyn në fshatin Izbicë të Skënderajt dhe kryen krime, duke mos kursyer as fëmijë e gra.

MASAKRA E REZALLËS

Më 5 prill 1999 forca të armatosura hyn në këtë fshat të Skënderajt dhe bënë krime, duke vranë e masakruar fshatarët e këtij fshati, madje edhe fëmijë e gra.

MASAKRA E MEJËS

Më 27 prill 1999, në kulmin e ofensivës serbe kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, në fshatrat Mejë dhe Korenicë të komunës së Gjakovës ka ndodhur një nga masakrat më të rënda të luftës. Forcat serbe kanë ekzekutuar 377 civilë të paarmatosur, 376 shqiptarë dhe një rom, përfshirë katër gra, ndër të cilat edhe Klaudia Malaj, 15 vjeçe, që konsiderohet viktimë më e re e kësaj ngjarjeje.

MASAKRA E DUBRAVËS

Në burgun famëkeq të Dubravës së Istogut, që nga muaji dhjetor 1998 e deri në qershor 1999, netët dhe ditët e tmerrit nuk do të harrohen kurrë. Të gjitha ato barbari ishin të vështira për të gjithë ata shqiptarë që ishin të burgosur në Dubravë...

MASAKRA E KRUSHËS SË MADHE

Një masakër e njohur dhe e tmerrshme ndodhi edhe në Krushë të Madhe të Rahovecit, më 25, 26 dhe 27 mars 1999.

MASAKRA E RUGOVËS SË HASIT

Një masakër tjetër në vitin 1999 ishte kryer në Rugovë të Hasit dhe ngjarja ishte shumë rrëqethëse.

MASAKRA E STUDIMES

Masakra në Studime të Vushtrrisë, ku forcat paramilitare serbe, më 2 maj 1999, vranë 140 civilë shqiptarë, do të mbahet mend edhe për një akt të guximshëm të një gruaje, e cila në mënyrën më fatlume kishte shpëtuar fëmijën e vet 2-vjeçar, të cilin paramilitarët serbë ia kishin rrëmbyer nga krahu i saj dhe për t'ia kthyer i kërkonin para.

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



PSE SIVJET **17 SHKURTI** FESTOHET NDRYSHË?

17 shkurti i këtij motmoti.

Ditë e datë historike.

Në këtë datë u shpallë Pavarësia e Kosovës.

Është datë e rëndësishme për historinë e vendit tonë të dashur. Këtë ditë e sollën shumë breza që sakrifikuan, flijuan veten e tyre në luftën e gjatë për Liri e Pavarësi.

Por, pas 18 vjet Pavarësi, çfarë arritëm?

Çka na solli kjo klasë politike?

Ka të arritura, ka zhvillim, por sa janë ato?

Siç thonë shumica, më shumë na sollën papunësi e varfëri, hajni, pasiguri e vrasje...

Na sollën shumë e shumëçka jo të mira, për çka na bën që këtë të kremte të madhe sivjet të mos e festojmë më ashtu siç duam.

Kosova fle mbi ar, por është bërë e varfër sot.

Politikanët u pasuruan e janë të pasur.

Shqiptarët historikisht dëmin më të madh ia kanë bërë vetvetes, duke iu referuar thënies së Faik Konicës: "Në qoftë se Shqipëria do të vdiste ndonjëherë, atëherë në epitafin e saj do të duhej të shkruhej: "Shqipëria lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, vdiq nga politikanët!".

Dhe, si atëherë, si sot, pikërisht politikanët kanë qenë ata dje e po janë ata sot që e prishin jetën e popullit, e ndreqin jetën e vet.

Ç'do të thotë kjo?

E sivjet, në vend të kremtes, sheshet e Prishtinës do të mbushën me protestues në përkrahje të krerëve të UÇK-së që po gjykohen padrejtësisht në Hagë, sepse populli është me ta, është me UÇK-në...

Gani Dili

150 euro pension, 100 euro e 90 centë ilaçe!

Sa rrënon sheh e dëgjon shumëçka, thoshin të vjetrit...

Dhe, vërtet, kjo thënie është aktuale gjithmonë, e edhe sot.

Pse?

Sepse, ditë më parë, teksa prisja në barnatoren që gjendet përballë ish-Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, afër Xhamisë së Madhe në Prishtinë, një i moshuar paksa më shumë se unë, e si duket i lodhur nga mosha e barra e jetës, priste në rend me një raport të mjekut në dorë për të blerë barëra.

Rreshtohem pas tij.

Ia jep farmacistes raportin.

Ajo i lexon në heshtje emrat e barërave dhe me lapsin që mbante në dorën e djathtë i nënvizon dy barëra.

I tha klientit:

"Të gjitha barërat i kemi veç këtyre dyjave që i nënvizova".

"Në rregull. M'i jep ato që i keni, kurse barërat që nuk i keni i kërkoj në barnatore

të tjera", i tha ai.

Farmacistja me raportin në dorë në raftet e farmacisë i merrte barërat një nga një, duke i bërë grumbull pranë kompjuterit. Dhe, kur mbaroi së grumbulluari, secilin ilaç një nga e incizoi në kompjuter që t'i lexohej çmimi. E, kur përfundoi, i tha klientit: "100 euro e 90 centë kushtojnë". Thënë të drejtën, mbeta i shtangur, ani pse barërat nuk ishin për mua e as që kisha për t'i paguar unë.

Plaku nxori nga xhepi një 100-she dhe ia dha farmacistes, duke i thënë se edhe 1 euro do e gjej në xhepa...

"Jo, s'ka nevojë më shumë! Një euro e ke prej meje!", ia ktheu ajo.

Ndërkohë, farmacistja barërat i hodhi në një qese të madhe najloni, e cila, edhe pse ishte e madhe, u mbush si mbushet qesja me molla në treg dhe pasi u soll rreth sportelit ia dha qesen e mbushur me

barëra klientit, i cili duke i thënë "Ditën e mirë", doli nga barnatorja.

Në çast mbeta pa tekst...

100 euro barëra, kurse 150 euro pensioni!

Jetë i thënçin kësaj!

E, në mbrëmje, teksa i dëgjoj lajmet në TV, temë dite ishte vendimi i Ministrisë së Financave se pensionistët kontribut-dhënës më s'kanë nevojë të paraqiten çdo 6 muaj si deri më tash.

Por, një i moshuar në sheshin e Prishtinës, i tha gazetares: "Nuk është gajle a paraqitem çdo 6 muaj, por më mirë do ishte po të na i kishin rritë pak pensionet se mbaruam!".

Dhe, me po të njëjtin konstatim të plakut në sheshin e Prishtinës po e përmbyllë këtë shkrim, temë e ndjeshme e një pjese të madhe të popullatës sonë, e cila po i kalon ditët si është më së keqi...

I. ILAZI

Pse Kosova ngrihet në këmbë për Hashim Thaçin?

Hashim Thaçi, emër që ngritë në këmbë fshatin e lindjes, Burojën, por edhe mbarë Kosovën e më gjerë, gëzon besimin e jashtëzakonshëm të të gjithëve. Në kujtesën e çdo banori të Burojës Hashimi edhe si fëmijë njihet si shumë i pjekur, shumë i disiplinuar dhe i përkushtuar për lirinë dhe patriotizmin.

Buroja, fshat me rreth 360 shtëpi, i djegur në luftë tërësisht, me rreth 60 martirë të pushkatuar në fshat me rrethinë, i ripërtëritur pas lufte, me shtëpi të reja dhe shumë dëme, të dielën, më 18 janar 2004, lagej nga shiu dhe rrihej nga një erë e fortë. Fshati i përbaltur, pa rrugë dhe pa kushte të jetës, pret të ardhme të sigurt, duke u betuar në Hashim Thaçin, kryetar aktual i PDK-së, ish-kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe ish-Drejtor Politik i UÇK-së, veprimtar në vendlindje dhe në ekzil.

Aktualisht, njeriu më i besueshëm i Drenicës, llogaritet ta nxjerrë nga terri social Drenicën, me rrugë të shkatërruara dhe me infrastrukturë të djegur nga lufta.

"Babanë tim e kapën në shtëpi dhe e rrahën, e keqtrajtojnë rëndë në pleqërinë e tij të shtyrë, sepse ishin të mbushur helm në Hashim Thaçin, i cili po i konsolidonte radhët e UÇK-së, për ta shpëtuar popullin nga Serbia dhe për ta shpërruar Serbinë nga Kosova", thotë Hajdin Xhavit, i lindur më 1969 në Burojë.

Sidoqoftë, Serbia tha se do e fshinin Burojën nga faqja e dheut, për faktin se, pikërisht, nga këtu, dilte një forcë e hekurt, që do e varroste Serbinë pas 100 vjet sundimi.

E, i madh e i vogël, në fshatin e tij të lindjes, në gjuhën e cicërimës, flasin kur zihet në gojë emri i Hashim Thaçit...

Në Burojë flasin se familja e Hashim Thaçit, që nga gjyshi e më herët nga sundimi i Austro-Hungarisë, pat burra të kombit dhe i dha gjak e nder Drenicës dhe Kosovës në kohë të vështira.

Në kohën e pajtimit të gjaqeve, kur i madhi Anton Çeta me rini pajtoi kosovarët e hasmuar, Buroja për

këtë problem s'pat nevojë të trokiste në dyert e askujt, sepse nuk kishte familje të hasmuara.

Sepse, në Burojë, 18 kilometra në jugperëndim të Skënderajt, jetohet në harmoni të plotë dhe afërsi vëllezërore...

HASHIMI, I VEÇANTË NË SHKOLLË E NË JETË

Bashkëmoshatare i tij, Ilmi Kas-trati, me të cilin Hashim Thaçi ka mësuar në shkollën fillore "Liria" në Turiqec, mban mend se Hashimi ka qenë i vetmi nxënës, i cili nuk është ngatërruar shumë në lojërat e moshatarëve, e posaçërisht në lojërat me top.

"Ai, zakonisht, mësonte... Kurrë nuk e ke parë pa libër në duar dhe ishte nxënës i më i përpiktë sa i përket disiplinës", thotë Ilmiu dhe shton: "Kur ne, nxënësit, luanim futboll dhe kur ne, në Drenicë, ishim më temperament, Hashimi gjithmonë na këshillonte dhe na mbante ligjëratë se si e kishim të nevojshme të mbanim dhe ruanim vëllazërinë. Ne kemi kundër kujt ta shprehim kundërshtimin dhe forcën!", na thoshte ai, i bindur se "duhet të organizohemi kundër dhunës serbe. Por, si kusht që kjo të ndodhë, ne duhet të jemi vëllazër..."

Gjithnjë kishte prirje të na këshillonte dhe mendjen e kishte kundër Serbisë.

Hashimi ka qenë shumë specifik. Nuk ishte kundër askujt në popull. Herët ishte i orientuar për lirinë e Kosovës dhe i preokupuar me patriotizëm.

Ka qenë i veçantë, sepse, kur fliste





Tahir Thaçi

për çlirim, thoshte se nuk bëhej pa derd-hur gjak.

Nuk fliste kurrë se duhej kursyer jetën për vendin.

Ai e ruante qetësinë dhe disiplinën në çdo gjë të mundshme.

Ishte shembullor në shkollë dhe si fëmijë kishte kulturë të lartë. Bile, ne mahiteshim me të, duke i thënë qysh është e mundur që djali i pestë i Haxhiut, edhe drenicas edhe kaq i kulturuar!

Hashimi gojë kishte e gojë s'kishte!", spikati Ilmiu, duke e kthyer kujtesën në kohën e fëmijërisë.

Sidoqoftë, Ilmiu nuk befasohet me kulturën e tillë jetësore dhe politike të Hashimit, pasi edhe prindërit e tij ishin në po atë rrugë lirie.

Hashimi, sipas Ilmiut, qysh në fëmijëri jepte sinjale të një strategu patriotik dhe qysh atëherë në fshat e rrethinë kishte filluar të flitej se në Drenicë po vjen një personalitet që do të ngadhënjej kundër Serbisë...

HASHIM THAÇI U INKUADRUAR NË LËVIZJEN PËR ÇLIRIM QYSH SI NXËNËS I GJIMNAZIT NË SKËNDERAJ

"Gjimnazi në Skënderaj Hashim Thaçin e gjeti të përgatitur me ide revolucionare dhe të gatshëm për sakrificë e liri të

Kosovës.

Hashim Thaçi gradualisht po qasej në veprimtarinë ilegale kundër regjimit okupues serb në Kosovë, si i vetmi çelës kundër Serbisë së uniformuar në Kosovë", thotë Ilmi Kastrati, shoqëruar nga katër bashkëvendës të tjerë të Burojës, duke konsideruar se kanë nderin të flasin për Hashimin, jo pse është nga ky fshat, por pse është i gatshëm të sakrifkohet për Kosovën dhe shqiptarët.

"Ai as sot nuk na ka harruar. Çdo fundjavë vjen në Burojë. Është shumë modest, ashtu sikur ishte si fëmijë.

Kurrë nuk i është shmangur fshatit të lindjes. Me çdo njeri që takohet ndalet dhe i flet, pret njerëz për biseda. I merr këshillat dhe i përcjellë ato.

Kjo bën që ta duam shumë, por ajo që na bën ta duam edhe më shumë është tjetra:

Kurrë nuk kemi frikë se ai e shet Kosovën dhe popullin e vet!

Jemi të sigurt te ai. Prej tij nuk pritet tradhtia kurrë...

Të tillë e ka pasur edhe familjen. E ka edhe sot... Tradita e ka përcjellë edhe këtë si katragjyshin e tij, Smajl Tafilin, babagjyshin e Sinan Idrizit, si dhe babën e tij. Familja e tij, që nga Smajl Tafili e këndej, e ka humbur pasurinë për komb, duke luftuar kundër Serbisë në Kosovë, por edhe duke pasur rezultate konkrete në këtë qëllim", thonë bashkëvendësit e tij në Burojë.

HASHIM THAÇI EDHE NË FAKULTET ISHTË I PËRNDJEKUR POLITIK

Duke rikujtuar kohët e hershme, bashkëmoshatarët e Hashim Thaçit në Burojë, dëshmojnë se ai në Skënderaj ishte nxënës shembullor dhe i tillë vazhdoi edhe në studime në Prishtinë.

Dhe, për shkak të veprimtarisë patriotike, Hashim Thaçi u bë i përndjekur politik, pas organizimit të një sërë rezistencash në dëm të regjimit okupues në Kosovë. Edhe Fakultetin Filozofik e kreu si student i shkëlqyeshëm dhe u desh të largohej nga Kosova në Zvicër, ku zgjeroi lëvizjen për çlirim të Kosovës.

"Për ne është nder dhe ngrihemi në këmbë kur e përmendim emrin e Hashim Thaçit, njeriun e madh të Burojës", ndërhyjnë njëri i ri, që ishte luftëtar i UÇK-së.

Ç'THOTË TAHIR THAÇI NGA BUROJA?

Dhe, duke e plotësuar fëmijërinë e Hashim Thaçit, plaku Tahir Thaçi, nga Buroja, pohoi

se Drenica ka pasur shumë djem që nuk e kursejnë jetën për Kosovë, por Hashimi gjithmonë ka qenë i përkryer.

"Unë nuk di që, ndonjëherë, ky njeri ka rënë në provim, qysh nga fëmijëria e hershme.

Nuk ka pasur fëmijë më të mirë. Ishte i pjekur edhe si fëmijë dhe kishte ndikim të madh te bashkëmoshatarët.

Si i vogël ka qenë ideal. Pastaj, e udhëhoqi luftën. Kjo nuk na befasoi, sepse e kemi njohur si fëmijë e tutje, sepse besimin e ka krijuar vetë, duke mos gabuar askund. Ka qenë me ideale të larta dhe nuk është përzier me fëmijë në lojëra, por rrinte me libër në dorë. Fëmijët e Burojës dhe të Turiqecit e konsideronin si mësuesin e dytë dhe këshilltar të tyre.

E dëgjonin kur fliste, ishin kureshtarë çka u thoshte...

Babai i Hashimit, Sinani, ka qenë i varfër. Ai i rriti gjashtë djem e dy vajza. I mësonin mirë fëmija edhe në ato kushte që i kishte, por patriotë ishin të gjithë", shton Tahiri, duke treguar respekt për të gjithë liderët tanë politikë në Kosovë.

Ai në odën e tij të re, pranë shtëpive të djegura, thotë se ka pritur shumë nga Hashimi qysh si fëmijë dhe u ka thënë të tjerëve se ai djalë do t'i shërbejë kombit, sikur familja e tij që i ka shërbyer gjithnjë.

"Familja Thaçi nuk ka pasur kurrë intencë diskriminuese ndaj asnjë minoriteti", tregon Tahiri, duke e lidhur traditën e familjes së Hashimit me kohën e gjyshërve që ia kishin falur pasurinë një ashkalie, duke e ndihmuar edhe financiarisht të mbijetonte.

Dhe, të gjithë ata që e njohin si fëmijë Hashim Thaçin, si Halili e Mehdiu, kanë qenë të bindur se Hashimi do të jetë një lider i së ardhmes në Kosovë...

DJALOSHI QË NUK LAVDËROHEJ

Drejtori i shkollës në Turiqec, Asllan Osmani, arsimtar me përvojë të ndritshme, personalitet i respektuar në Burojë para lufte, gjatë dhe pas lufte, prind që forcat serbe në Burojë ia pushkatuan djalin, thotë se Hashim Thaçin e kishte nxënë në shkollën fillore në Turiqec.

"E kisha nxënë në vitet 1983-1987. I kam dhënë lëndën e matematikës. Si nxënë ka qenë i shkëlqyeshëm, fenomenal dhe shumë i matur", pohon Asllani dhe shton:

"E kishte një kulturë që shumë dallonte prej të gjithë nxënësve të tjerë, e mund të them edhe në raport me shumë personalitete të kohës.

Ku e mori ai kulturën, aq i përkryer dhe i matur në sjellje?

Gjithmonë kam pritur se do të jetë një

figurë e rrallë...

Kam folur shpesh me kolegë në shkollë për Hashimin dhe jemi pajtuar se ky nxënës do të jetë një dritë e madhe e kohës në të ardhmen.

Hashim Thaçi ka qenë një nxënës që kishte guxim ta ngrite botërisht zërin kundër dhunës serbe në Kosovë.

Si mësues i tij, ndihem krenar që kam pasur rastin ta kem nxënës timin!”, spikat Asllan Osmani, në shtëpinë e tij.

Dhe, tre mësimdhënës të tjerë të shkollës në Turiqec, duke folur për Hashim Thaçin, pohojnë se ai ishte shembull për të gjithë nxënësit...

“E mbajmë mend fare mirë se ai ishte shembull si duhej të ishte nxënësi. Kishte gjykim të drejtë për gjërat, nuk ishte frikacak. Për shokët e gjeneratës mund të ishte profesor e prind.

Familja e tij ka traditë të pasur patriotike dhe Kosovës i ka dhënë shumë burra të ndritur e të sakrificës”, thonë ata në rrugë, mu pranë pompës së derivateve në Burojë.

NË MENDJEN E THAÇIT - VETËM LIRIA!

Xhavit Hajdini (1966), thotë ta kenë lutur gjithnjë të merrte pjesë në lojëra, por ai qëndronte duke lexuar.

“Zakonisht, lexonte libra të historisë. Më duket se u hynte me rrënjë, sepse na shpjegonte gjëra që kurrë nuk i kishim dëgjuar.

Na shpjegonte gjëra të organizimit kom-bëtar dhe thoshte se regjimin e egër të Serbisë kurrë nuk do e shporrim pa luftë të organizuar, ose pa intervenimin e botës në Kosovë.

Ndonjëherë na dukeshin përralla gjërat që ai i thoshte. Dhe, kur erdhi lufta, ne ia thoshim njëri-tjetrit ato që i kishim



Asllan Osmani

dëgjuar nga Hashim Thaçi si fëmijë... Pra, jemi shumë të lumtur që e kishim bashkëmoshatarë”, thotë Xhavit, në Burojë.

HASHIMI DHE JETA NË ZVICËR

Mehdi dhe Halit Thaçi, me statut të përkohshëm në Zvicër, shpalosin kalimthi disa detaje të gjendshmërisë së liderit të PDK-së, Hashim Thaçit.

“Sa i përket jetës dhe punës në Zvicër, Hashim Thaçi kurrë nuk ka luftuar për poste dhe qëllime përfitimi. Ai ishte strateg që përforconte vazhdimisht rrjetin e bashkëpunimit patriotik për Kosovën. Opinionet e tij në Zvicër ishin të shumta. Flitej se ai organizonte veprimtari të rëndësishme për çlirimin e Kosovës. Dhe, prej fëmijërisë që e njohim Hashim Thaçin, ai ka bërë vepra kundër Serbisë. Në Zvicër thoshin se ju nuk dini se Hashimi merret me punë të mëdha dhe ato kanë të bëjnë vetëm me Kosovën”, thonë Halil e Mehdi Thaçi, në shtëpinë e tyre në Burojë.

BASHKË NË VUAJTJE, BASHKË NË LUFTË

“Në fëmijëri e kishin dëgjuar duke folur se shoku-shokun, luftëtarin, e ndihmon në

luftë dhe në momentet më të vështira”, thotë Tahir Thaçi, një burrë që ka kryer punë të rëndësishme komunale dhe shumë i shkathtë në kujtesë.

Mban mend Tahiri se Hashimin e kishte takuar tri herë gjatë luftës në Kosovë gjatë ofensivave serbe në Drenicë.

“Më 1988 e takova në Ticë, ku ishte spitali i të plagosurve. I vizitonte të plagosurit”, thotë xha Tahiri dhe vazhdon:

“Është sjellë jashtëzakonisht mirë me popullin, ka qenë gjithnjë afër tyre për gjithçka”, thotë ai.

Tahirit i kujtohet se atë natë, në Ticë, Hashimi nuk fjeti, por i bashkoi familjet, të cilat kishin mbetur të shpërndara, pasi ofensivat serbe i kishin dëbuar nga shtëpitë e veta.

“Edhe 12 ditë të tjera në Plluzhinë, afër Likocit, Hashimi ka qëndruar duke e ndihmuar popullin”, thotë Tahiri dhe vazhdon: “Hashimi ka udhëhequr me çdo gjë dhe nuk di se ai njeri ka bërë një gjest të keq në luftë. Ka udhëhequr me gjakftohtësi dhe përpikëri, e populli e ka dashur tepër, sepse ishte me popullin në kohën kur ishte luftë e vuajtje.

Ai edhe sot vjen në Burojë dhe nuk kalon pranë asnjërit pa i folur dhe përshëndetur”. (“Kosovarja” nr. 2 dhe 3/2004)

Sokol Murturi



Ilmi Kastrati



SHKA "Afërdita" e Mushtishtit
në kohën e themelimit

A ka Kosova talentë të rinj?

Po të kthehemi në një kohë pas, në qendra të mëdha e të vogla të Kosovës ekzistojnë shoqëritë kulturore-artistike, të cilat, përveç begatimit të jetës nëpër vendbanime të ndryshme, kishin për qëllim edhe zbulimin e talentëve të rinj. Kujt s'i kujtohet Shoqëria Kulturore-Artistike "Afërdita" nga Mushtishti i Suharekës, "Shote Galica" nga Drenasi, "Zëri i Drenicës" nga Skenderaj, "Bajram Curri" nga Prishtina, "Kastriotët" nga Ferizaj, Shoqëria Kulturore-Artistike e Dushkajës së Gjakovës, e Isniqit, e Irbazit dhe e Strellcit të Deçanit, e shumë të tjera... Organizoheshin aso kohe koncerte, përkundër vështirësive dhe pengesave që dilnin nga regjimi i kohës që nga viti 1981 e këndej. Por, vullneti ishte mbi të gjitha... E, tash? Pse më nuk kemi shoqëri të tilla?

S'ka më koncerte as në kryeqendër, as nëpër qendra komunale, e të mos flasim për vendbanime më të vogla! Pse këngëtarët tanë, siç thotë populli, janë bërë pikë e pesë? Pse secili këqyr vetë me përfitua? E, kush s'e bën dert punën e cilësisë! Pse pseudovlera ka zënë rrënjë në Kosovë? Pse Ministria e Kulturës së Kosovës dhe sektorët nëpër komuna nuk dalin me projekte për zbulimin e talentëve të rinj, e që, pa dyshim, nuk janë të paktë në Kosovë? Shkurte Fejza, Ilir Shaqiri, Shyhrete Behluli, Remzie Osmani, Mahmut Ferati, Shaqir Cërvadiku, Nysret Muçiçi, motrat Mustafa, Xhavit Sadiku, Riza Bytyçi (dikur Shpresa Berisha, Bege Gashi, Resmie Kida...), e shumë e shumë këngëtarë të tjerë, a do të ishin këta që janë sot po

të mos ekzistojnë aso kohe shoqëritë kulturore-artistike, në të cilat ata bënë hapat e parë dhe u pjekën në këngëtarë që kultivuan këngën e mirëfilltë shqipe? Mbase, ndokush edhe mund t'më kritikoj si njeri që kam mbetur me mendje të vjetër, njeri me ide të demoduara, por realiteti kosovar në këtë lëmi flet më së miri... Andaj, njerëzit përgjegjës në institucionet tona të kulturës duhet vënë gishtin në kokë dhe të mendojnë edhe për ata që kanë talent e s'kanë mundësi të depërtojnë nga kultivuesit e pseudovlerave tallava, të cilët, jo vetëm që nuk i kontribuojnë këngës së mirëfilltë shqipe, por, përkundrazi, e bastardojnë, duke i dhënë këngës shqipe ngjyrimet turke, greke, rome, e madje edhe sllave! Keq, a? Deri kur kështu?!

I. ILAZI



MICHAEL KORS

IAS
SINCE 1971

BLEJ ONLINE



Intervistë e para 9 vjetëve me Xhemajlije Demaçin

Me profesion mësuese, bashkëshortja e Adem Demaçit, Xhemajlija, është nënë me të cilën krenohet kombi shqiptar. Xhemajlije Hoxha-Demaçi, ka kaluar një jetë të tërë, e përcjellë nga UDB-a e regjimit serbo-sllav. Nënë dhe bashkëshorte e cila ka përjetuar peripecitë më të tmerrshme njerëzore me tri dekada të burrit në burgjet e tmerrshme jugosllave. Xhemajlije Demaçi është sinonim i sakrificës për liri e arsimim, në një paralelizëm vuajtjeje, duke marrë rolin e gruas dhe burrit, nënës dhe babait për dy fëmijët që nuk i donte regjimi (Shqiptarin dhe Abetaren), pasi ishin të Adem Demaçit.

E përcjellë nga varfëria në jetë dhe nga urrejtja e shtetit që e trajtonte si armike të popullit, Xhemajlije Demaçi, tek përcillej në çdo hap nga pjesëtarët e UDB-së, kujdesej ta ruante çdo shoqe dhe çdo njeri, duke e kufizuar bisedën deri në limitin e vetëm - një përshëndetjeje, që mund të bëhej apo të mos bëhej fare.

Si nënë e dy fëmijëve që rriteshin nën presionin e pushtetit komunist, Xhemajlije Demaçi u ballafaqua edhe me problemet shëndetësore të fëmijëve, më shumë të djalit.

Dhe, falë këmbëngulësisë së saj, ajo i detyroi mjekët ta shpëtonin Shqiptarin, që ishte buzë greminës shëndetësore.



NGA SAKRIFICA DERI NË DITËT E LUMTURA

**Për Ju është folur e shkruar shumë.
Megjithatë, na thoni, kush është
Xhemajlije Demaçi?**

- Xhemajlije Hoxha-Demaçi është një person që si çdo njeri i pati momentet e bukura e të hidhura të jetës. Isha bijë, motër, hallë, teze, grua, mësuese, por rolin më të vështirë e më të bukur e pata, si çdo grua tjetër, të isha nënë. Të gjitha vështirësitë e pengesat, të gjitha mundimet e mia si njeri, natyra i ka shpëguar në mënyrën më të mirë. Jam në moshën kur i mbledh dhe i kujtoj momentet e jetës... Të gjitha ishin të magjishme e të bukura.

**Keni pasur shumë peripeci jetësore,
shkaku i burgosjes së bashkëshortit
Tuaj, Bacës Adem. Si ka rrjedhur jeta
Juaj si grua dhe nënë?**

- Si grua ka qenë një jetë shumë interesante në fillim, por e shkurtër.

Si për shumicën e grave shqiptare të Kosovës të asaj kohe, jeta ishte me shumë vështirësi dhe në kufi me kushtet minimale. Por, entuziazmi për jetën e njerëzit i kapërcyen vështirësitë. Në atë kohë shumica e njerëzve kishin kushte jete modeste, por mes veti ishin shumë solidarë. Në fillim pata vjehrrën Nazife si nënën time, e cila më këshillonte e më ngushëllonte, por me të jetova vetëm 3 vjet, pasi ajo vdiq nga një sëmundje e rëndë në vitin 1966. Familja ime më ndihmoi gjithëherë, veçanërisht vëllai, Arif Hoxha (Mitrovicë, Prishtinë) dhe familja e tij e ngushtë, motrat e mia: Myzaferja (Pejë) e Bedihaja (Mitrovicë) me familjet e tyre të ngushta, përfshirë dhëndurët Kadrush Balën, nga Peja, dhe Halil Radoniqin, nga Mitrovica, që ishin shumë bujarë e burrnorë me mua e fëmijët e mi.

A keni qenë e izoluar nga rrethi shkaku i rrethanave politike të kohës?

- Në atë kohë isha shumë e angazhuar në punë e mbijetesë, kështu që nuk e kam ndier fort ndonjë farë izolimi. Thashë, edhe më parë, se njerëzit, edhe pse frikoheshin nga politika e pasojat e saj, nuk frikoheshin të shprehnin simpatinë e të jenë zemërapur.

A u kanë përcjellë udbashët në punë, në rrugë, në jetë, në përgjithësi?

- Gjithkund e gjithmonë ka bashkëpunëtorë të armikut. Dikush me më pak e dikush me më shumë zarar. Ka pasur raste kur më kanë përcjell, p. sh., gjatë zhvillimit të orëve të mësimi e futnin syrin e veshin në vrimë të çelësit, deri në stacion të autobusëve, kur shkoja në punë në fshat. Por, nuk di saktë kush ishin ata. Cilët ishin e si ia bënë dinë ata vetë! Por, nuk i gjykoj. Në atë kohë ai regjim i ka shtrënguar e detyruar njerëzit të bëjnë gjëra që nuk i kanë dëshiruar as ata vetë.

Jeta Juaj si mësuese?

- Kam kaluar mirë me nxënës dhe prindërit e tyre. Kanë qenë shumë bashkëpunues e bujarë në fshatra ku punoja. Prej vitit 1990 punova 12 vjet në Prishtinë, por kujtimet e mia janë shumë më intensive të kohërave



kur punoja në fshatra (1957-1990). Ndoshta, sepse isha më e re atëherë...

Me çka jeni ballafaquar më së shumti gjatë rritjes së fëmijëve, kur vetë është dashur të jeni edhe nënë edhe babë?

- Me fëmijët, Abetaren e Shqiptarin, kemi kaluar jetë modeste, por të organizuar. Fëmijët ndiqnin shkollën me shumë sukses, që për ne ishte një kënaqësi e madhe dhe shtytje e fuqishme për arritje të reja dhe si premtim që t'i ushqenim shpresat për të ardhmen.

Si e ndieni veten si bashkëshorte e Bacës Adem, burrë i cili tërë jetën e vet ia kushtoi kombit shqiptar?

- Unë isha bashkudhëtare, në formën time, të atij oqeani të idealizmit e

sakrificës së Ademit, i cili nuk ishte vetëm simbol i qëndresës, por edhe i shpresës, se për popullin e trevave shqiptare në ish-Jugosllavinë kolonizatore do të vinin, patjetër, ditët e lirisë e të përparimit kombëtar.

Si jeton sot Xhemajlije Demaçi?

- Tash jam pensioniste, gëzoj shëndet relativisht të mirë për moshën time. Jetoj me Ademin, i cili, edhe pse i sëmurë, mbush, së paku, fizikisht mangësitë e kohëve të shkuara; jetoj me djalin Shqiptarin e familjen, pra një familje e mrekullueshme, ku kam një mbështetje të madhe nga reja ime, Arbëria, për t'ma lehtësuar e zbukuruar jetën, e veçanërisht i kam për qejf nipat: Diellin (20 vjeç), Feniksin (18 vjeç) dhe mbesën Latrën (17 vjeçe). Me Abetaren e fëmijët e saj: Atdehun (26 vjeç), Dëshirën (23 vjeçe), Laurën (11 vjeçe) dhe dhëndrin Besimin. Dëgjohem përditë me ta në telefon, bisedojmë dhe kënaqemi. Bisedoj shpesh në telefon me vëllanë, Arifin, fëmijët e tij dhe me fëmijët e motrave. Kam shoqe të mrekullueshme: Haliden, Kimeten, Mejremen, Esmën, Shefkinazen, Remzijen, Ajeten, Zylfijen, Hazbijen...

Çka për fund?

- Ju falënderoj për intervistë. Revistës suaj të nderuar i dëshiroj suksese të mëtejme! Njëkohësisht, me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, shpreh urremtet e mia më të sinqerta për popullin tonë të vyer kudo që ndodhet.

**Gani Dili
Safet Krivaça**

P. S. Ky shkrim është botuar në "Kosovaren" nr. 13/2017. Po e ribotojmë me rastin e 5-vjetorit të vdekjes së saj.



Edhe 100 vjet s'ka perspektivë!

Në Kosovë po bëhet gjithnjë e më vështirë për të jetuar, duke pasur parasysh varfërinë e madhe, çmimet në qiell, papunësi e madhe dhe pasojat që vijnë prej saj, konkretisht mundësia shumë e vogël për të krijuar familje etj. Andaj, çka presim nga jeta? Në këtë pyetje morëm këto përgjigje...

**LUL GASHI, PRIZREN:
NGA JETA KAM PRITUR,
POR KOT!**

- Nga jeta kam pritur qysh se e kreve shkollën e mesme në Prizren, e që po bëhen 10 vjet!
Por, asgjë s'realizova!
Mendoj se kështu do më shkoj jeta...

**ALINDA, GJAKOVË:
KOHË E VËSHTIRË KA
ARDHUR!**

Secili njeri i ka shpresat për një jetë më të mirë, ëndrrat e tij.
Unë, e që tash jam në vitin e fundit të studimeve, thënë të drejtën, kam oferta për martesë, por para meje më dalin pyetjet: Si do të martohem kur ende nuk e kam një vend pune?
Kush do na e paguaj banesën?
Kush do i mbaj fëmijët e mi?

Kush...?
Thënë shkurt, kohë e vështirë ka ardhur!

**FITI, FERIZAJ:
EDHE 100 VJET S'KA PER-
SPEKTIVË!**

- Jam maturante në Gjimnaz. Por, edhe pse edhe pak muaj kanë mbetur të diplomoj, më duhet të studioj desha a s'desha, sepse nuk mund të gjej vend pune.
Andaj, pak pres nga jeta, sepse në Kosovë, me kushtet që i ofrohen rinisë, në 100 vjetët e ardhshëm nuk do të ketë perspektivë!
Keq, a?

**LAZIMI, GJILAN:
PERSPEKTIVA ËSHTË
PËRPARA...**

- Ka pesë vjet që punoj në një firmë private, por thënë të drejtën as firma s'i

ka punët mirë, meqë prodhimet nuk po i shiten si duhet e edhe shpenzimet janë bërë të mëdha.
Por, shpresa më mban se do të vijnë ditë të mira, se "Dielli do të lindë përsëri!", siç pat thënë me një rast ish-Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.
Andaj, edhe mua më mban shpresa se dielli do të lindë përsëri, se do nga kthehet e mbara dhe do të stabilizohemi sado pak, në mënyrë që të mos mendojmë vetëm si të ikim në vend të huaj.
Dhe, dashtë Zoti e u bëftë siç po them!

PËR FUND

Skamje për shumicën e popullatës së Kosovës - po.
Jeta e shtrenjtë - po.
Papunësi e madhe - po.
Dhe, çka jo tjetër?
Por, na mban shpresa se gjërat do të ndryshojnë dhe do të vijnë në vend të vet...

Diturie Haxhaj

Lum shqiptaria që e ka!

Shkas për këtë shkrim është një bisedë e para pak ditëve me aktorin e madh të skenës shqiptare, Xhevat Limanin, në njërin nga televizionet shqiptare të Maqedonisë, e që me zërin e tij karakteristik në studio i recitoi vargjet e poezisë së Migjenit “Pak dritë o shok, o vëlla” të Migjenit.

Xhevat Limani u lind më 1 janar 1953 në Fierishtë të Strugës. Diplomoi në Akademinë e Arteve të Bukura në Prishtinë.

Ka luajtur në një varg rolesh në teatër dhe në disa filma artistikë.

Është skenarist dhe regjisor i filmit të parë shqiptar në Maqedoni me titull “Fatprerët”, pedagog i lëndës së aktrimit në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit të Tetovës. Prej vitit 2002 punon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku edhe i ka realizuar disa shfaqje.

“Në Prishtinë studiova aktrimin dhe letërsinë. Diplomova në klasën e Faruk Begollit, një pedagog i shkëlqyer dhe aktor filmi. Letërsinë e mora për t’i dëshmuar babait tim aftësinë time.

Ai në fillim nuk më mbështeti, duke aluduar se unë duhej të studioja mjekësinë apo drejtësinë.

Por, unë nuk i doja këto fakultete. Ëndrra ime mund të realizohej vetëm përmes artit dhe letërsisë.

Në aktrim ka diçka që të shenjtëron: je vetëm ti dhe publiku. Të gjithë sy e vesh i kanë drejt teje”, thotë ai në një prononcim të tij.

KRIJIMTARIA ARTISTIKE

“Nuk ishin vetëm” (film dokumentar për shqiptarët e Amerikës në luftën e UÇK-së); “Pranverë dimërore”, poezi; “Albaniada”, dramë; “Artisti pa Atdhe”, roman; “Dodona”, dramë; “Ora shqiptare”; “Demoniada”; “Antimemorandum”; “Anatema”; “Hijet”; “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”; “Muri i lotëve”; “Unë - Adem Jashari”.

Është nderuar me një varg çmimesh dhe mirënjohesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

Por, shkas i këtij shkrimi është recitimi në studio i poezisë së Migjenit “Pak dritë o shok, o vëlla”, zëri i tij në fillim melankolik e më pastaj kumbues sa edhe më dridhej trupi kah e dëgjoja.

“Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vlla. Të lutem, pak dritë në këtë natë kur shpirti vuen,

Kur të dhemb e s’di ç’të dhemb, e syni gjum nuk ka,

Urren e nuk din ç’urren, don e s’din se ç’don.

Pak dritë! O burrë! O hero, ngado që të jesh...

Burrë që shkatrron edhe që ndërton sërish!

Pak dritë vetëm, të lutem, mshirë të kesh,

Se do çmendem në këtë natë pa gjumë dhe pa pishë.

Oh! Ta kisha pishën të madhe dhe të ndezun!

Me flakën e pishës në qiellin e kësaj nate

Ta shkruajsh kushtimin... Ehu burrë i tretun

Do ta shifsha vallen tande në majë të një shpate.

Por pishë nuk kam e vetëm janë burrat, shokët...

Dergjem n’errsinë pa gjumë dhe pa dritë...

Askush s’më ndigjon, çirrem kot më kot...

Hesht more, hesht! Por qindro, o shpirt!

Gjeli këndon dhe thotë se asht afër drita

– Gjeli, rren a s’rren? Cila asht fjala e jote?

Kur ti këndon thonë se asht afër drita...

Por unë s’besoj sonte në Çalët e kësaj bote.

Hiqmoni qafe, mendimet!

O jastëk ty të rroki, të përqafoj si shpëtimin,

Më fal atë që due: gjumin dhe andr’min

E dy buzëve që pëshpërisin ngushëllimin.

I. ILAZI



Nga pak...

Punët llugë n'tana anët...

DISA PARTI I DREJTOHEN GJYKATËS KUSHTETUESE PËR GJITHÇKA!

Disa parti politike e push-tetarë i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për gjithçka, kur atyre nuk u ecë kungulli mbi ujë!

Disa ankohen në Kushtetuese edhe për gjëra krejt të imta. Kjo të jep të kuptosh sikur të kontestohet një vegsh në të cilin dihet se zihet fasulja. E dimë çka në të, kurse e kontestojmë në Gjykatën Kushtetuese se çka po zihet brenda vegshit!

E, vonesa e bërjes së shtetit me dy organet më vitale, parlamentin dhe qeverinë, dihet se do të ketë kosto të lartë...

PREJ NJË RRENE NË RRENË TJETËR...

Kishte shkuar një njeri i pasur në një fshat për të gjetur nuse për djalin e vet dhe si bazë të vlerësimit e kishte marrë një parim: ajo vajzë që kishte më së paku bërlllok në shtëpi do të bëhej nuse e djalit të tij.

Hyn në një shtëpi dhe e pyet një vajzë:

"Po kërkoj bërlllok me mbledh!"

"Kemi sa të duash!", i thotë ajo.

"Kah të kthehem e marrë!", ia kthen ai.

Hyn në derën tjetër dhe njëjtë.

E, kur hyn në derën e tretë, një vajzë i thotë se në shtëpinë e saj nuk ka bërlllok, sepse ajo vetë e pastron shtëpinë tri herë në ditë.

Andaj, mu ajo vajzë edhe bëhet nuse e të birit të tij. Ky tregim i përgjigjet më së

miri situatës së shtetit tonë, Republikës së Kosovës. Siç po shkojnë punët, bërlllok në të gjitha anët...

Pata shikuar filmin "Shekulli madhështor". Para qindra vitesh, sulltani i madhëri- ishëm, Sylejmani, ua hiqte kokat stafit perandorak nëse kapeshin në hajni apo në ndonjë lloj krimi ekonomik. Pra, e zbatonte ligjin edhe para 600 vjetësh! E, tash, në shekullin XXI, ende politikanët tanë nuk marrin asnjë lloj përgjegjësie për asnjë shkelje ligjore!

E PRENË DEGËN KU RRI VETË!

Kishte hipur një njeri mbi degë lisi dhe e prente degën ku qëndronte ai vetë.

Kalon aty pari Nastradini dhe, posa e pa se po e prente degën ku ai qëndronte vetë, i thotë:

"O burrë, do rrëzohesh se po e prenë degën ku ti rri vetë!"

Druprerësi i tha:

"Shiko ti punën tënde! A nuk ke me çka tjetër të merresh, por me mua, a?!"

Nastradini vazhdon rrugën, kurse ai posa e preu degën bie në tokë...

Kur ra në tokë tha se kalimtari paska pas qenë profet dhe i sulet pas. Kur e arriti, i tha:

"Ti qenke profet! Më trego kur do të vdes?"

"Nuk e di!", ia ktheu Nastradini.

Por, meqë ai këmbëngulte t'i tregonte, i tha:

"Ti do të vdesësh kur të rrëzohet tërë lisi!"

"E, si po e di?!", e pyeti.

"Sepse, ai të shtypë dot!"

Andaj, edhe pushtetarët tanë janë të tillë. Nuk dinë se po rrëzohen edhe kur e humbin pushtetin. Të tillët mendojnë se ende mund të del ndonjë zgjidhje, helbete...

S. M.



MARIGONA HILL



+383 49 162 000

+383 48 162 000

info@marigonahill.com



Pse s'kemi nxënës të edukuar si dikur?

Stresi “po i mbytë” nxënësit. Kjo moshë ndikohet shumë nga grupet shoqërore ku përfshihen, duke rënë pre e duhanit apo edhe të vetive të tjera të këqija...

Psikologët tregojnë për problemet emocionale, psikologjike dhe ankthet e nxënësve të shkollave të mesme. Dhe, duke lexuar shkrimet në gazeta, ku shpesh adoleshentët qëllojnë me gjëra të forta njëri-tjetrit, të duket se je duke parë film...

A NDIHEN TË PASIGURT NXËNËSIT NË SHKOLLË?

Kjo është një pyetje shumë aktuale për nxënësit e shkollave të mesme. Shkollat e mesme të Prishtinës janë në monitorimin e personave të sigurisë, por nuk dimë si qëndron puna në shkollat e komunave të tjera. Sidoqoftë, edhe pse në secilën shkollë të

mesme të Prishtinës në hyrje të shkollave është shërbimi i sigurisë, megjithatë, po ndodhin gjëra të këqija ndërmjet nxënësve, madje edhe rrahje si në filma. Dhe, dashur e pa dashur te nxënësit me sjellje të mira lind një lloj pasigurie...

NXËNËSIT PINË DUHAN NË RRUGË, NË LOKALE!

Kudo afër shkollave tona në kryeqytet ka lokale me bollëk. Në përgjithësi, duke qenë se janë adoleshentë, tipar i kësaj moshe është ndikimi nga grupi shoqëror. Pranimi ose përjashtimi nga grupi është një arsye e fortë, që i bën ata të nisin duhanin dhe alkoolin.

Shtrohet pyetja: Cili është motivi i pirjes së duhanit?

Kjo është një pyetje e cila lidhet me nivelin social-ekonomik të familjes, nivelin arsimor të prindërve ose nivelin personal të arritjeve të nxënësve.

Një ndër arsyet e përgjithshme është se prindërit tregojnë pak interesim për fëmijën e tyre adoleshentë.

Prindërit i mendojnë të mirat materiale dhe kushtet fizike për fëmijët, por harrojnë se ata kanë nevojë për një komunikim të

mirë dhe vëmendje.

Marrëdhënia prind-fëmijë është shumë e rëndësishme dhe kur fëmijët arrijnë moshën e gjimnazit ata befasohen me ndryshimet që pësojnë. Kjo lidhet edhe me mentalitetin dhe dhunën që ushtrohet në familje.

Një baba i dhunshëm dhe autoritar rritë fëmijë të dhunshëm...

KONFLIKTET I SHKAKTOJNË NXËNËSIT PROBLEMATIKË...

Maturantja e një shkolle të mesme në Prishtinë, V. G., thotë se brenda ambientit të shkollës ndihet e sigurt.

Por, si kudo tjetër, në çdo klasë ka nxënës problematikë dhe ndaj tyre çdokush është indiferent...

Sidoqoftë, ajo thotë se pasigurinë më të madhe e ndjen për shkak të ankthit që i krijohet për rezultatet në mësim dhe të ardhmes së saj pas përfundimit të maturës.

Për fund, shtrohet pyetja: Pse s'kemi nxënës të edukuar si dikur?

Diturie Haxhaj



MARIGONA[®]
SUN

+383 48 226 111
marigonasun.com



Gruas sime i pëlqente jeta rrugaçe!

Jam nga Presheva. Qe 30 vjet jetoj në Zvicër. Gjatë verës që shkoi dy javë i kalova në Durrës. Atje u njoha me një vajzë, që e quanin Gentiana. E ftova të pinim kafe në një lokal që ndodhej buzë detit dhe filluam të bisedonim me njëri-tjetrin për gjërat e kaluara: ajo të vetat e unë të miat. Dhe, përfunduam me martesë. Por...

Menjëherë pas njohjes shkëmbyem numrat e telefonit për të qenë në kontakt me njëri-tjetrin. Kah mbrëmja ajo më dërgoi një sms që të takoheshim përsëri të nesërmen.

Në sms shkruante: "Në ato momente, kur isha me ty, ndjehesha e qetë dhe e lumtur, por kisha shumë emocione që të flisja hapur dhe lirisht, prandaj po të dërgoj këtë sms".

Unë iu përgjigja me sms se do të takoheshim përsëri të nesërmen e do të flisnim gjerë e gjatë e më hapur me njëri-tjetrin.

Të nesërmen ajo më mori në telefon dhe e lamë vendtakimin po te i njëjti lokal ku kishim pirë së bashku.

Kur arrita në lokal ajo veç ishte ulur në tavolinë në verandën e lokalit. E pyeta:

"Ke shumë kohë që më pret?".

"Qe gjysmë ore jam këtu", tha.

Morëm pije, pastaj biseduam gjerë e gjatë për çdo fushë të jetës.

Më tha se i pëlqente të bënim një xhiro buzë detit dhe vazhduam të flisnim për dëshirat e jetës.

Në një moment, më pyeti:

"Çfarë të pëlqen më shumë te një vajzë që preferon të bëhet gruaja jote?".

"Më pëlqen thjeshtësia, sinqeriteti dhe të jetë e edukuar", i thashë.

Ajo, pasi më shikoi drejt në sy, më tha: "Do ta dish realitetin e jetës sime? Të intereson?".

"Pse jo?!", ia ktheva.

Ajo nisi t'më tregonte një histori dashurie që e kishte zhgënjyer dhe filloi të qante. Në atë moment i hodha dorën në qafë dhe vazhdova t'ia fshija lotët.

Ajo m'u mbështet në kraharor pastaj më dhuroi një puthje.

Dhe, mu ajo puthje më bëri që të ndjeja dashurinë që po hapte derën e zemrës sime...

A MUND TË VIJ ME TY NË ZVICËR?

Në njërën nga ditët që kalonim bashkë në plazhin e Durrësit, më tha:

"Mund të vij me ty në Zvicër?".

"Pse jo! Atje mund të punosh dhe banojmë bashkë", ia ktheva.

Dhe, dy ditë para se të kthehesha në Preshevë, vendosa të shkoja në familjen e saj.

E, pas një bisede goxha të gjatë, ramë dakord që ajo të vinte me mua në Zvicër...

Por, për çudi, pas dy muajsh iku nga banesa ku jetonim pa më treguar fare!

Nuk e dija se ku kishte ikur...

Telefonin e mbante fikur...

E kërkova një muaj dhe u pajtova me fatin se më nuk do e gjeja, se ndoshta ishte martuar me tjetër burrë...

I telefonova familjes së saj se mos ishte kthyer në Shqipëri. M'u përgjigjën – jo.

Sidoqoftë, pas një kohe, kur u ktheva nga puna, në shkallët e banesës ku jetoja më priste ajo!

Nuk u besoj dot syve të mi!

Pasi hymë brenda filloi t'më tregonte pse kishte ikur. Arsyeja ishte se i pëlqente jeta rrugaçe...

Por, unë nuk isha i interesuar për një femër rrugaçe. Ishta i interesuar për femër që do më bëhej grua, andaj edhe ia dhashë lamtumirën...

Ard H., Zvicër



FEEL THE *BEAT* OF *MARINA BAY*



marinabay.al

+355 69 604 1000

Rr. "Aleksandër Moisiu" Uji i Ftohtë, Vlorë



RRJETET SOCIALE PO FITOJNË, NJERIU PO HUMB



Dikur thuhej si nëmë: "Folsh me gishta!". Sot kjo shprehje duket se e ka tejkaluar kuptimin e saj fillestar, sepse ne nuk po flasim më as me gishta. Gishtat na janë ngjitur pas celularit.

Kushdo që përdor rrjetet sociale e njeh këtë skenar. Në realitet nuk ke fare kohë, por dëshiron vetëm të dërgosh shpejt një SMS apo të hapësh një email. Megjithatë, mjafton një prekje e ekranit dhe magjia virtuale ka ndezur shkëndijat e para. Një foto, një video, një story. Vetëm edhe një. Dhe papritur, me një ndjenjë zhgënjimi të lehtë, kupton se koha ka rrëshqitur pa u vënë re, ndërsa arsyeja pse more telefonin në dorë është zhdukur.

Shumica prej nesh priret ta nënvlerësojë ndikimin real të mediave

sociale. Ne besojmë se të varur janë gjithmonë të tjerët, jo unë e as ti. Por psikologjia bashkëkohore e varësisë sugjeron diçka tjetër. Pas shumë sjelljeve kompulsive fshihet shpesh një ndjenjë boshllëku emocional ose nevoja për stimulim të menjëhershëm.

Platformat sociale e shfrytëzojnë këtë mekanizëm në mënyrë sistematike. Reagimet e menjëherëshme, si pëlqimet, komentet dhe shpërndarjet, aktivizojnë çlirimin e dopaminës, neurotransmetuesit të lidhur me sistemin e shpërblimit në tru. Ky proces biologjik e përforcon sjelljen e rikthimit të shpeshtë në platformë.

Megjithatë, konfirmimi social, si në jetën reale ashtu edhe në atë virtuale, nuk është kurrë konstant. Pikërisht kjo paparashikueshmëri e shpërblimit, e njohur në psikologjinë biheviore si përforsim me interval të ndryshueshëm, rrit ndjeshëm potencialin varësues të këtyre platformave. Si pasojë, tek individit mund të shtohen mëdyshjet, pasiguritë dhe prirja për krahasim të vazhdueshëm me të tjerët, një dinamikë që studimet e lidhin me rritje të ankthit, ulje të vetëvlerësimit dhe përkeqësim të mirëqenies mendore, veçanërisht tek të rinjtë.

Po aq shqetësues mbetet edhe deformimi i perceptimit të realitetit përmes formateve të njohura televizive që promovohen si jetë reale. Paradoksi është i dukshëm. Publikut i thuhet vazhdimisht se bëhet fjalë për lojë, por kjo lojë është ndërtuar me aq mjeshtëri sa arrin të kapë vëmendjen dhe investimin emocional të shikuesit. Në këtë mënyrë, ndërsa ne konsumojmë realitete të fabrikuara, realiteti ynë i përditshëm vazhdon të tkurret minutë pas minute përpara ekraneve.

Edhe pse, nga një këndvështrim profesional mbi vetëdijen kolektive, këto formate mund të ofrojnë materiale të vlefshme për të kuptuar dinamikat shoqërore, mbetet një e vërtetë thelbësore e ekonomisë së vëmendjes. Nëse nuk paguan për produktin, ka shumë gjasa që produkti të jesh ti vetë.



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges



"Enzo Attini" zgjeron universin e stilit: nga syzet ikonike te bizhuteritë virale

Në një treg ku trendet ndërrojnë me shpejtësi, "Enzo Attini" ka zgjedhur një rrugë tjetër: evolucion të qetë, por të sigurt, duke ruajtur identitetin që e ka kthyer në një nga emrat më të dalueshëm në segmentin e syzeve dhe aksesorëve premium.

Këtë sezon brendi vjen me risi që nuk janë, thjesht, zgjerim koleksioni, por një hap i menduar drejt një universi më të plotë stili.

NJË KAPITULL I RI: NGA BYZYLYKËT TE VARËSET DHE VËTHËT

Risia më e madhe është zgjerimi i linjës së aksesorëve përtej byzylykëve, me prezantimin për herë të parë të varëseve dhe vëthëve.

Ky zhvillim shënon një moment të rëndësishëm për "Enzo Attini", duke e shtrirë gjuhën e tij vizuale në forma të reja, pa e humbur qartësinë estetike që e karakterizon.

Koleksioni i ri mbështetet në një qasje të guximshme, por të rafinuar. Zinxhirët, detajet ikonike dhe përzgjedhja e materialeve premium krijojnë aksesorë që nuk janë, thjesht, plotësues të veshjes, por pjesë që marrin rol kryesor.

Çdo element është konceptuar si një deklaratë stili, një shprehje e karakterit të atij që e mban, duke ruajtur balancën mes luksit bashkëkohor dhe elegancës së përjetshme.

FRYMËZIM ITALIAN, QASJE MODERNE

Në thelb të koleksioneve të reja qëndron eleganca klasike italiane, e ndërthurur me ritmin e jetesës moderne.

Linjat e pastra, format e balancuara dhe minimalizmi, janë në qendër të dizajnit, duke krijuar aksesorë që janë të bukur sot dhe relevantë edhe pas shumë sezonesh.

"Enzo Attini" nuk ndjek trendet e shpejta. Frymëzimi vjen nga ideja e stilit të qëndrueshëm, të atij stili që ndërtohet me kohë dhe shprehet natyrshëm përmes detajeve të menduara mirë.

Eleganca qëndron në përmbajtje, jo në teprim.

Kjo filozofi e bën çdo pjesë të veshshme në përditshmëri, por njësoj të përshtatshme edhe për momente më formale.

MATERIALE QË GARANTOJNË CILËSI DHE QËNDRUESHMËRI

Thelbi i çdo krijimi "Enzo Attini" janë materialet. Përdorimi i stainless steel 316L, i kombinuar me larje ari të vërtetë 18K dhe gurë zirkon, garanton qëndrueshmëri dhe një estetikë premium që ruhet në kohë. Kjo përzgjedhje nuk është rastësore, është një zgjedhje që reflekton ambicien për të ofruar produkte që zgjasin dhe që mbajnë të paprekur karakterin e tyre.

Dizajnet dallohen për linja të pastra dhe forma të strukturuar. Te orët kjo filozofi shfaqet përmes gdhendjeve të punuara me dorë dhe përfundimeve të rafinuara, që i japin çdo modeli identitet unik.

Ndërsa, syzet realizohen me punim artizanal, duke kombinuar bio-acetat dhe elementë gold me larje në ar të vërtetë 18K. Lente të polarizuara me mbrojtje të plotë UV sigurojnë jo vetëm estetikë, por edhe



funksionalitet dhe rehati në përdorim të përditshëm. Koleksionet u dedikohen individëve që kërkojnë cilësi reale dhe stil të qëndrueshëm – njerëz që e shohin aksesorin si pjesë të identitetit të tyre, jo si një trend kalimtar.

NGA SHTËPIA E BBVA TE PUBLIKU I GJERË

Prania e syzeve dhe aksesorëve “Enzo Attini” në “Big Brother VIP Albania” ka sjellë një lloj ekspozimi që shkon përtej marketingut tradicional. Banorët kalojnë 24 orë nën vëzhgim dhe zgjedhja e tyre për aksesorë që funksionojnë realisht në përditshmëri: të rehatshëm, të qëndrueshëm dhe estetikisht të fortë, është një provë konkrete e cilësisë.

Një detaj domethënës është fakti se disa prej tyre i kanë kthyer syzet “Enzo Attini” në syze optike, duke i përdorur si pjesë të domosdoshme të jetës së përditshme brenda shtëpisë. Kjo e zhvendos produktin nga roli i një aksesorit “për kamera” në një objekt funksional, që provohet në kohë reale. Ndikimi në publik ka ardhur natyrisht.

Audienca identifikohet me modele specifike sipas personazheve që ndjek, duke e bërë brendin pjesë të stilit të tyre personal.

Në këtë mënyrë, “Enzo Attini” nuk paraqitet si një ekspozim i sponsorizuar, por si një zgjedhje që testohet dhe përdoret çdo ditë dhe kjo është forma më e fortë e prezantimit.

ÇFARË PRITET MË TEJ?

Brendi nuk ndalet këtu. Në horizont janë disa lansime të rëndësishme që do ta pasurojnë më tej universin “Enzo Attini”.

Një nga risitë më të afërta janë orët “Attini” në një interpretim të ri: më sportive, më “casual” dhe më të përshtatshme për përditshmëri, por duke ruajtur gjuhën e dizajnit që e dallon markën.

Paralelisht pritet një gamë e zgjeruar modelesh të reja syzesh, me dimensione të ndryshme, lente shumëngjyrëshe dhe detaje të përmirësuara si në estetikë ashtu edhe në funksionalitet.

Qëllimi është i qartë: më shumë liri zgjedhjeje për klientët, pa kompromis në cilësi dhe stil.

Po ashtu, është në përgatitje një koleksion i ri perlash, varësesh dhe bizhuterish të tjera, duke i dhënë linjës së aksesorëve një dimension edhe më të plotë.

Në thelb, filozofia mbetet e njëjtë: evoluim i vazhdueshëm, dizajn i men- duar mirë dhe produkte të destinuara për t'u përdorur çdo ditë, jo vetëm për t'u admiruar.

Për të eksploruar koleksionin e plotë, vizitoni faqen zyrtare enzoattini.al ose dyqanin në “Sheshin Wilson”, Tiranë.

“Kosovarja”





Sevim Sulejmani nga sukseset në karrierë e deri te dhimbja për humbjen e mikes

Sevim Sulejmani, të cilën shumica e njohin si Sevi, është nga ato gra që nuk bëjnë shumë zhurmë, por lënë gjurmë.

Nënë e një vajze 7 vjeçe, ajo e përshkruan veten si një grua që nuk dorëzohet lehtë.

Jeta i ka sjellë sfida, por në asnjë moment nuk ka zgjedhur rrugën e lehtë.

Me besim, përkushtim dhe punë të ndershme, ka ditur t'i përballojë situatat, duke mbajtur njëkohësisht në ekuilibër familjen dhe profesionin.

Përditshmëria e saj është intensive: punon në spital dhe paralelisht menaxhon sallonin e saj të bukurisë. Dy botë të ndryshme, por që për Sevim lidhen nga i njëjti parim: përkujdesja ndaj njerëzve. Që nga viti 2019 është e angazhuar me shumë dashuri në fushën e estetikës, duke u fokusuar kryesisht, në trajtimet e qerpikëve, vetullave dhe grimin profesional. Në sallon punon së bashku me një partnere frizere, duke ofruar një paketë të plotë shërbimesh për klientët. Për të kjo nuk është thjesht punë; është pasion që i jep mundësinë të krijojë dhe të ndërtojë marrëdhënie të drejtpërdrejta me njerëzit.

Formimin profesional e ka ndërtuar në Zvicër, ku ka përfunduar certifikime dhe trajnime në fushën e estetikës.

Nëse një trajtim nuk është i përshatshëm për klientin, ajo ia thotë hapur.

Beson se besimi ndërtohet me transparencë dhe komunikim të drejtë dhe, pikërisht, kjo e ka bërë të fitojë respektin dhe besnikërinë e klientëve të saj.

JETA KA VLERË MË TË MADHE SE GJITHÇKA...

Së fundi, jeta e ka vënë përballë një dhimbjeje të madhe, humbjes së mikes së saj të ngushtë, Shqipës. Një shoqëri 14-vjeçare, e mbushur me kujtime dhe energji pozitive, u ndërpre papritur.

Shqipja u nda nga jeta në moshën 33-vjeçare, duke lënë pas dy fëmijë.

Për të kjo humbje nuk është vetëm një plagë personale, por edhe një kujtesë e fortë se shëndeti është mbi gjithçka.

Paratë, sukcesi, angazhimet, të gjitha zbehen përballë vlerës së jetës...

Në pyetjen për planet, buzëqeshë lehtë dhe thotë se kohës i përket fjala e fundit, meqë ka mësuar se rruga ndërtohet hap pas hapi, me punë, durim dhe besim. Sidoqoftë, Sevim Sulejmani mbetet shembull i një gruaje që di të mbajë shumë role pa humbur thelbin: një nënë e përkushtuar, një profesioniste e saktë dhe një njeri që e vendos zemrën në gjithçka që bën.

NDJEK TRENDET DHE TEKNIKAT MË TË AVANCUARA

Ajo vazhdon të investojë në vetvete, duke ndjekur trendet dhe teknikat më të reja, sepse beson se cilësia nuk është rastësi, por rezultat i përkushtimit të vazhdueshëm.

Specialiteti i saj janë trajtimet e qerpikëve dhe vetullave, ku synon gjithmonë rezultate natyrore dhe të personalizuara.

Për Sevim bukuria nuk duhet të jetë maskë, por theksim i asaj që je.

Ajo që e dallon nga shumë profesioniste të tjera është sinqeriteti.

Në një fushë ku shpesh fitimi vendoset mbi gjithçka, Sevi zgjedh korrektësinë.



Pse Yllka Gashi nuk dëshironte të bëhej presidente e Kosovës?



Në një intervistë të realizuar para 20 vjetësh nga Revista jonë, "Kosovarja", me Yllka Gashin, aktoren tonë me renome botërore, ajo shprehu dëshirën se po të lindej edhe një herë do dëshironte të bëhej profete. Pse?

Nëse... do të lindeshe edhe një herë, çka do të bëheshe?

- Profete! A ka më mirë?!

Nëse... do të ishte kryetare e Kosovës, si do të veproje?

- Kurrë nuk do t'isha bërë kryetare e Kosovës! Pse t'i shtoj vetes telashe?

Nëse... do ta kishe shkopin magjik, çfarë do të ndryshojë?

- Një herë e përgjithmonë do t'i ndaloja luftërat!

Nëse... jeta jote do të varej prej një puthjeje, kush do të ishte ai që do e kishe preferuar?

- Jam e sigurt që jeta ime asnjëherë nuk

do të varej nga një puthje...

Nëse... dikush të thotë se je më e mira, ç'bën?

- Qeshi, kryesisht. Unë e di kush jam. Komplimentet nganjëherë më bëjnë nervoz e nganjëherë më pëlqejnë, por varet edhe kush më jep komplimente...

Nëse... të jepet mundësia të shohësh çfarë nuk shohin të tjerët, çka do të doje të shihje?

- Trurin. Kisha pasur shumë dëshirë të shihja se çfarë ka në brendinë e tij...

Nëse... merr ftesë nga Holivudi, por me kusht ta ndërrosh identitetin, çka do të bëje?

- Ha-ha-ha, po ku ka më Holivud se Kosova?!

P. S.

Yllka Gashi, e lindur më 1982, është aktore jona e njohur, kryesisht, me rolin e Zanës në serialin "Familja Moderne".

Në vitin 2015 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me bashkëshortin dhe vajzën e vogël. Zbulimi amerikan i Yllkës erdhi në filmin e mirënjohur "Zgjoji" të Blerta Bashollit, i cili u bë filmi i parë që fitoi tre çmime të mëdha në Festivalin të Filmit "Sundance" në Konkursin Botëror të Kinemasë Dramatike.

Të më duash edhe kur dielli nuk rrezon për mua!

MUNGESA

Ka gjithmonë diçka që na mungon. Edhe kur duket sikur i kemi të gjitha, sërish diçka mungon, ani pse as që mund të jemi të vetëdijshëm se çka është ajo. Një mungesë, një vend bosh, një hapësirë që nuk mbushet kurrë...

DASHURIA

Natë e ftohtë dhjetori, dashuria ngrohte një çift të ri që shkëlqenin më shumë se çdo dritë dekoruese. Sikur e gjithë dashuria e botës ishte mbi ta.

E bukur t'i shohësh, por edhe e dhimbshme ta mendosh atë se a do të jenë prapë nesër bashkë, apo e ardhmja do t'i ndajë rrugët e tyre e do të lë dhimbje pas...

E trishtueshme të mendosh që edhe nëse do të jenë bashkë e ta kurorëzojnë dashurinë e tyre, 1000 problemet e jetës mund ta mbysin shkëlqimin e tyre.

Shijojeni momentin, përqafohuni, jetoni rininë dhe mos kurseni për dashuri! Pse?

Sepse, e nesërmja mund të jetë e bukur, por e kaluara është e magjishme.

MIQTË

Ndërpreva miqësinë time me dy persona: Me njërin, se kurrë nuk foli për veten e tij dhe me tjetrin se kurrë nuk foli për mua!

Sa të rëndësishëm janë miqtë, çfarë vlere kanë në jetën tonë?

A e dimë, a e mendojmë, a e çmojmë miqësinë e pastër?

Mik, të dua për atë që je dhe jo për atë që duhet të jesh!

Të dua për të folur me ty kur askush nuk dëshiron t'më dëgjoj!

Dua të flas përçartë dhe t'më kuptosh!

Dua t'më pranosh edhe në ditët kur dielli nuk rrezon për mua!

NJERIU

Harrojeni çdo të keqe, lëreni pas lumin e turbullt, gjejini oazën tuaj të pastër, të bukur.

Hapeni zemrën dhe flisni.

Harrojeni krenarinë e sëmurë.

Harrojeni egon e çmendur.

Të qenit dhe të treguarit njeri nuk është e vështirë, s'ka definicion që duhet ditur, nuk është formulë, ekuacion, matematikë.


COURTYARD[®]

BY MARRIOTT




MUAJI I RAMAZANIT NË FRYMËN E
MIRËQENIES

Dy kohë





Është lehtë me gjet femër, por vështirë me e mbajt!



Pra ca netësh u gjenda në dhomën ku banojnë tre studentë të vitit të parë, nga vise të ndryshme të Kosovës. Bashkë i ka bërë fakulteti ku studiojnë – ndërtimtaria. Asnjëri nuk mban të fshehtë asgjë: as prej nga janë, as a shkojnë me rregull në ligjërata, as a kanë dashnore dhe as ku rrinë me to... Sidoqoftë, po të mos kishin obligim me i ndjekur ligjëratat, jeta studentore u duket interesante, e papërsëritshme...

FLAKRONI, STUDENT I NDËRTIMTARISË: NUK KA KRIZË PËR FEMRA, POR SI ME I MBAJT?!

- Jam nga Nerodimja e Ferizajt. Jam i bukur dhe për mua nuk ka krizë për femra. Por, disa femra edhe dinë të të mashtrojnë... Ka ditë që bisedoj me njëren që është në grupin tim, por, edhe pse sot e lamë të takohemi para fakultetit para orës 10, kur edhe fillojnë ligjëratat, për çudi nuk erdhi. Dhe, prita e prita derisa u mërzita dhe ia mësyva amfiteatrit që të mos vonohesha në ligjërata.

MEMLI, STUDENT I NDËRTIMTARISË: ËSHTË VËSHTIRË TË KESH FEMËR NËSE S'KE PARA!

- Jam nga Klina. Nuk qëndroj materialisht mirë, por as keq. E, për të dalë me femra duhet pasur para, ani pse çdo javë familja më japin para me vete sa herë që shkojë

në shtëpi. Sot është lehtë me gjet femër, por si me e mbajt? Duhet me dalë çdo mbrëmje me të në kaficë. Pijet po kushtojnë goxha shtrenjtë. E, të mos flasim nëse shkojmë të hamë darkë në ndonjë restorant: 20 euro të shkojnë aty për aty! Kështu, pra, është vështirë të kesh femër nëse s'ke para!

ARLINDI, STUDENT I NDËRTIMTARISË: "A KE TË DASHUR?", MË THA NJË VAJZË NË AUTOBUS...

- Jam nga Deçani. Nuk kam dëshirë t'u vardisem femrave, sepse kjo gjë më poshtëron. E, disa nuk e kanë gajle nëse femra ua thotë ndonjë ofendim, qoftë edhe ndonjë fjalë të rëndë. Unë, si inatçi do pëlcisja nga inati... Por, po u tregoj për rastin që më ndodhi dje në autobus derisa udhëtoja nga

fakulteti deri në qendër të qytetit: Një vajzë kërkoi të ulej në karrigen pranë meje. E pashë se dëshironte të hynte në muhabet me mua... Pa prituri më pyeti se a kam femër. Jam ndier në mat-pozicion, sepse nuk kam pasur më herët rast t'më drejtohet ndonjëra në këtë mënyrë... Por, rasti i saj më dha mësim: Disa femra kanë dëshirë të arrijnë deri te "princi" i tyre pa pasur nevojë për ndërmjetësues, sepse dëshirojnë që lidhja e tyre të jetë në fshehtësi të plotë.

U PAFSHIM!

Pas nja dy orë bisedë, më cingëroi telefoni dhe një shoqe imja kërkonte të takohemi, sepse ashtu e kishim biseduar kohë më parë. Me një "U pafshim!" u përshëndeta me ta dhe të nesërmen në Redaksi i radhita këta pak rreshta në notesin tim, si dëshmi jete studentore...

Burim Bajrami





TATA
STAYS

Every stay, A DIFFERENT STORY.

Një hapësirë ku dizajni takon përvojën e qëndrimit. Epoque by Tata Stays është konceptuar për ata që vlerësojnë estetikën, qetësinë dhe detajet e menduara me kujdes.

E vendosur në zemër të Prishtinës - vetëm 200m nga Katedralja "Nënë Tereza" - ofron një ambient modern, elegant dhe mikpritës, i përshtatshëm si për udhëtarët e biznesit ashtu edhe për çiftet që kërkojnë një arratisje urbane.



PRISHTINË, KOSOVË

Rezervo përmes Airbnb ose na shkruaj në DM
@tata.stays



“Guri i Vajzës”, shkëmb andej e këndeje rrugës në grykën e Rugovës, sipas legjendës, simbolizon shpëtimin.

Legjenda thotë se në rast rreziku, Zoti i lëvizë ata shkëmbinjtë për t’i ofruar shpëtim të rrezikuarit, të drejt, si në rastin kur e ka shpëtuar vajzën, të cilën e ndiqnin dhunuesit.

“Gurët kanë lëvizur dhe janë ofruar afër njëri-tjetrit aq sa e kanë mbrojtur vajzën nga dhunuesit”.

Kështu ka shpëtuar vajza nga dhunuesit, thotë legjenda, duke u

dhënë gurëve pamjen bindëse ku vajza kishte hedhur hapat mbi ta...

“GURI I SEFASË”

Vendi i quajtur “Guri i Sefasë” në Kuq është është një vend tjetër, nga i cili syri i njeriut sheh bukuritë madhështore të Rugovës.

Toponimi tjetër, “Kërrshi i Gjatë”, është një vend që veçohet për gjatësi të madhe. Janë interesante edhe vendet “Qafa e Diellit”, “Maja e Hellit”, “Huni i Maxhip-it”, “Qafa e Qyqes”, “Guri i Kuq” etj.

Dhe, teksa i japim fund një dite me udhëtim të gjatë në Rugovë, në mbrëmje shihen pak njerëz në këtë anë, sepse, ata që i hasëm gjatë ditës me bollëk, në mbrëmje kthehen kryesisht në Pejë

Ku ndodhet “Guri i Vajzës”?

a vende të tjera të Kosovës.

“Pakkush këtu jeton tërë kohën. Vetëm gjatë verës këtu jeta gumzhinë, kur edhe dalin me bagëti në stane”, thotë bashkëbiseduesi ynë, te i cili edhe kthjem të pimë kafe në restorantin e tij buzë rrugës.

SHTËLLUNGAT E BARDHA MBI BJESHKË...

E, kur perëndimi i diellit veç ishte ofruar, shtëllunga të bardha reshë përthekuan majat e bjeshkëve të larta dhe retë e dendura sa vinin e bëheshin më të zeza, e kjo ishte një paralajmërim se shiu veç sa nuk kishte filluar...

Sokol Murturi

 anaderm





Burri m'u ka bënë "vëlla"!

Mungesa e seksit në martesë duket se është një episod që përjetohet më keq nga gratë sesa nga burrat, sidomos kur ata që e refuzojnë raportin intim janë këta të fundit.

"Jam qe dhjetë vjet në martesë dhe, marrë në përgjithësi, të gjithë që më njohin mendojnë se kam një martesë të mirë. Mirëpo, nuk është bash kështu", shprehet Alma, nga Fushë-Kosova, në pyetjen që ia bëme se si i shkon jeta në martesë.

Alma, 42-vjeçe, pohon se kur ajo dhe burri i saj u takuan 15 vjet më parë, ata bënë seks në çdo kohë që ata mundeshin.

Por, pas pesë vjetësh martesë, jeta e tyre seksuale filloi të tkurrej, nga shumë herë në javë në një herë muaj!

Ajo nuk është e lumtur me këtë gjë, por burri i saj nuk është i interesuar për seks dhe nuk dëshiron të flasë sesi mund ta përmirësojnë këtë gjë që ajo e sheh si një problem të madh.

"Kam marrë një mori ankesash nga ai.

Ai nuk është i disponuar, sepse puna në lokal in e tij në restorant nuk po i shkon si duhet, se gjithmonë vjen në shtëpi i lodhur, se ka dhembje lukthi a gjetiu...", thotë ajo, e zhgënjyer me jetën e saj seksuale.

BURRI NUK DO TË FLASIM PËR SEKS!

Ajo dyshon se burri i saj, nëse nuk ka femër tjetër, ka humbur dëshirën për seks, por ai ka refuzuar të vizitohet te mjeku, me qëllim të tejkalimit të këtij problemi bashkëshortor.

Kur ajo flet për mungesën e seksit në raportin e tyre, burri i saj ose mbyllet ose merr pozicion mbrojtës.

Ajo i qahet atij se kështu ajo ndihet e shëm-

tuar dhe se ata janë kthyer në shok-dhomë. Gratë, ndoshta, nuk mund të varen nga burrat për të qenë nxitëset seksuale në marrëdhënie, por kjo nuk do të thotë se ato janë imune në refuzimin e seksit, sidomos me normat tona tradicionale gjinore ende me ndikim. Burrat ndjehen të poshtëruar kur ata nuk mund të kryejnë seks, edhe nëse kjo është një pengesë psikologjike apo çështje fiziologjike. Shkaqet e zakonshme fiziologjike që çojnë në rënie e dëshirës seksuale të burrave përfshijnë mosfunksionim të ereksionit, si përdorimi i medikamenteve (ilaçet kundër depresionit) dhe testosteroni i ulët ose problemet e marrëdhënieve në çift, thonë psikologët.

Sh. Sh.

FOUR POINTS

BY SHERATON

URIME MUAJI I *RAMAZANIT*



Mistere...

Në Gadime qeniet e mistershme loznin valle!

Në Gadime të Lipjanit është një vend i çudirave që njerëzit e vjetër e njohin si një xhungël të vogël, në të cilën dominojnë hutat e zi dhe gjarpërinjtë.

Një projekt para 50 vjetësh parashihte ndërtimin e një rruge asfalti nëpër grykën malore rreth 15 kilometra të gjatë nga Gjilani për në Gadime të Lipjanit, grykë me pamje të bukur piktoreske, që magjeps syrin e njeriut.

Nëpër luginën e atij vendi kalon lumi "Klisyrë", e që derdhet në lumin "Sitnica". Verës "Klisyrë" ka pak ujë, kurse dimrit zgjerohet dukshëm...

Historia e "Klisyrës" është me shumë enigma, shtojzovalle të natës e qenie të mistershme, që janë përfolur në tregime e legjenda dhe që vazhdojnë të fliten akoma nga brezi i tashëm.

Përgjatë luginës kishte mullinj, ashtu sikur kishte në Nerodime dhe në Jezerc të Ferizajt, ku njerëzit duhej të udhëtonin me ditë të tëra për të bluar grurin e misrin. Gjërat që tregohen prej shekujsh thuhet se lugina e "Klisyrës" kishte një krua në ahishtën e dendur nga drunjtë dhe po aty tash në kroit e akullt është ngritur një çezme prej betoni, në të cilën marrin ujë qindra njerëz në ditë, si ujë me shije për qaj e pije.

NATËN VALLËZONIN SHTOJZOVALLET...

Flitet se në vitet 1900 kalimtarët kishin hasur edhe në shtojzovalle, që dukeshin si femra të bukura.

Një tregim që është bërë legjendë thotë se një kalimtar, teksa kthehej natën në shtëpi, te kroi kishte takuar një femër të bukur sa nuk kishte hezitur të mos i shkonte pas, teksa ajo ngjitej lart ahishtës. Me flokë lëshuar për shpine dhe qeshje të lazduar ishte ngjitur lartësive, ndërsa udhëtari e kishte ndjekur pas.

Ndjekja kishte përfunduar pas disa orësh, kur udhëtari më nuk e kishte parë shtojzovallen.

Të njëjtën e kishin takuar edhe të tjerë dhe vasha e natës ishte bërë figura më e këndshme që mund të shihej te kroi i ahut, krua që ndodhet edhe sot aty ku ishte edhe dikur, para qindra vitesh. Figura e zanës më pas kishte filluar të bëhej e frikshme, kur malësorët e fshatrave përreth filluan të merrnin dru në atë vend, e që duhej kaluar edhe nëpër lumin "Klisyrë".

ZANA E NATËS I PËRMBYSTE QERRET ME DRU...

Atëbotë duart e padukshme i kishin hequr nga kuajt rripat dhe zinxhirët e qerres dhe i kishin trembur kuajt, kurse qerren e kishin përmbysur në ujë. Një rast tjetër, teksa zbrisnin malësorët në fshatrat e rrafshit, një burri i ishte ulur në qerre një keç i bardhë. Keci blegërinte, kurse malësori vetëm e shikonte. Dhe, herë-herë kuajt as nuk mund ta lëviznin qerren nga pesha e kecit, edhe pse ai në dukje të parë nuk ishte edhe aq i madh...

Rrëfimi tjetër thotë se disa mullinj, përgjatë luginës, ishin mbyllur, meqë misteret e natës hidhnin gurë mbi çatitë e mullinjve.

Ky, pra, është historiku i mistereve të kodra që ka formën e plisit, e që fillon me të hyrë në Gadimen e Epërme nga drejtimi i Gjilanit, ku sot njerëzit mu në atë vend kanë filluar të ndërtojnë kafene për pushim e relaksim.


S. Krivaça





ARRIJE PESHËN IDEALE NË VITIN 2026

Viti 2026 është koha ideale për të investuar në shëndetin dhe formën trupore. Arritja e peshës ideale nuk është vetëm çështje kilogramësh, por një proces që kërkon qasje profesionale, teknologji të avancuar dhe kujdes të personalizuar për trupin.



Qendra e Dobësismit Kenda Center përdor pajisje moderne me nxehtësi që ndihmojnë në stimulimin e metabolizmit dhe reduktimin e yndyrës trupore. Teknologji si Thermal Nest, Space Therapy dhe Infralight veprojnë përmes nxehtësisë së kontrolluar, duke ndihmuar trupin të djersijë, të relaksohet dhe të aktivizojë proceset natyrore të pastrimit dhe formësismit.

Një tjetër metodë efektive që përdoret në Kenda Center është EMS (Electrical Muscle Stimulation), e cila aktivizon muskujt përmes impulseve elektrike. Kjo teknologji ndihmon në tonifikimin muskular, përmirësimin e qarkullimit dhe formësimin e trupit, edhe për ata që kanë pak kohë për aktivitet fizik.

Falë kombinimit të teknologjisë me nxehtësi, EMS dhe udhëzimit profesional, **Kenda Center ofron një rrugë të sigurt dhe efektive drejt peshës ideale.** Me mbështetje të vazhdueshme dhe metoda bashkëkohore, 2026 mund të jetë viti kur transformimi yt bëhet realitet.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontakti në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse nuk na ecin gjërat mbarë?

Zonja magjistare, jam një zonjë që i kam kaluar të pesëdhjetat. Prej kur jam martuar, qe 31 vjet, gjërat nuk na ecin mirë e mbarë, sepse kurrë nuk kemi pasur jetë të mirë, edhe pse jemi në Perëndim. Ende nuk kemi as shtëpi tonën. Burri qe 10 vjet kërkon pension, por të paguajmë avokat nuk kemi mundësi. Nuk di si do të vazhdojë jeta jonë...

"Duke pritur"

Përgjigje:

Gabimi juaj është se nuk keni punuar, por keni jetuar nga ndihmat që ua ka dhënë shteti... Sistemi i vlerave perëndimore bazohet mbi punën dhe fitimin nga puna, e që juve u ka munguar. Nuk është në pyetje magjia, por e keni lënë anash punën dhe kjo ka bërë të mos keni bazë ekonomike. Gabimi është te qasja juaj dhe duhet ta ndryshoni këtë gjendje, duke i lënë me një anë ekzistencën nga pensionimet e hershme, sepse edhe ashtu nuk u bën nder e as progres ekonomik.

A do të ndryshojë vjehrra e vajzës?

E nderuar, jam një nënë me një problem prej shumë vitesh. Vajza ime e do një djalë qe disa vjet. Qe dy vjet është martuar, edhe pse nuk rri tërë kohën në shtëpinë e burrit shkaku i vjehrrës. Dua përgjigje prej teje se a do të ndryshojë vjehrra e vajzës, bile ndaj djalit të vet, sepse nuk kam parë nënë të tillë për djalin e vet?

"Nëna e brengosur"

Përgjigje:

Aktualisht, sot pak nuse i duan vjehrrat. Ato si nëna luftojnë që shtëpia të ketë një traditë dhe krenari dhe nusja të jetë e lavdëruar nga rrethi e masa. Kjo është dëshirë e vjehrrave, por për nuset dhe nënat e nuseve nuk tingëllon kështu. Sidoqoftë, nuk ka nënë që ia do të keqen djalit të vet, por nëse nusja e tepron, atëherë vlen fjala popullore "për inati të resë...". Unë nuk shoh se vjehrra është armike e djalit të vet, por normale është se as nuk do të ketë komandant në shtëpi.

Kam frikë se do të abortoj përsëri!

Jam 28-vjeçare, e martuar qe një vit. Jetën martesore e kam të mirë, por më është thyer zemra, sepse vitin që shkoi kam pasur një abort spontan nga një infektion gjinekologjik. A të filloj përsëri një shtatzëni të re?

"Alketa 28"

Përgjigje:

Sugjerimi im është ta evitoni plotësisht infeksionin gjinekologjik dhe vetëm pasi të konstatohet se infeksioni është eliminuar në tërësi, të filoni shtatzëni të re dhe nuk do u përsëritet asgjë e keqe. Trajtohuni te gjinekologu, sepse jeni rast për shërim...

A e kam fat personin që e dua?

Përshëndetje zonja magjistare, jam Arna nga Ferizaj, 23-vjeçare. Qe një vit jam në lidhje me një djalë. Dua t'më tregoni nëse personi që jam në lidhje me të është fati im apo jo, sepse e dua shumë?




"Arna, Ferizaj"

Përgjigje:

Duhet t'i sqaroni gjërat me të dhe jo të futeni në lidhje e pastaj të mos gjeni shtegdalje shpirtërore. Nëse duheni, apo nëse dashuria juaj është reciproke, ai do t'u propozojë fejesë. Por, nëse ai nuk e bën këtë, ti duhet ta iniciosh fejesën. E, nëse ai nuk përgjigjet pozitivisht, tërhiqni me kohë. Kjo është e tëra dhe nuk ka koment tjetër. Mos ec nëpër qiell e këmbët në tokë!



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix ks


+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC